



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË

VENDIM
Nr 28 Datë 28.04.08

PËR

MIRATIMIN E FONDIT PREJ 100 000 LEKE PER VLERESIMIN E
EKIPIT TE BASKETBOLLIT PER MESHKUJ "SKENDERBEU".

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e politikave të zhvillimit, Planifikimit strategjik dhe Koordinimit me Donatoret për "Miratimin e fondit prej 100 000 leke per vleresimin e ekipit te basketbollit per meshkuj "Skenderbeu", bazuar në ligjin nr. 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32 pika "dh", ligjin nr 8399 dt. 09.09.1998 "Për buxhetin lokal", Ligjin nr 9836 dt. 26.11.2007 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2008", Udhëzimin nr 4 dt. 17.01.2008 të M.F. "Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2008", Udhëzimin nr 258 dt.15.02.2008 të Ministrise se Brendshme "Për zbatimin e Buxhetit të Qeverisjes Vendore për vitin 2008", si dhe V.K.B. nr. 12 dt. 18.03.2008 "Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2008", mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit total prej 100 000 lekë per vleresimin e ekipit te basketbollit per meshkuj "Skenderbeu".
2. Ky fond do te perballohet nga fondi rezerve i te ardhurave te Bashkise me kete strukture buxheti:

Pakesohet	00.	04980	05	Art. 6090000	- 100.000 lekë
Shtohet	00.	08140	05	Art. 6020000	+100.000 lekë

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e politikave të zhvillimit, Planifikimit strategjik dhe Koordinimit me Donatoret dhe Klubi Shumesportesh.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare e Këshillit

Raimonda Nase

Raimonda NASE

Dixhitalizuar nga Qendra ÇIP
www.infocip.org